



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M  
K.P.P. 14/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|               |            |
|---------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar    |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj  | Anëtar     |
| Lindita Skeja | Anëtar     |
| Merita Zeqaj  | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 12.01.2021 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-80546-12-01-2020, me objekt “*Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara*”, me fond limit 20.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan.

**Ankimues:** “Medi Tel” sh.p.k.  
Autostrada Tiranë – Durrës, Km.1, Rruga “Vidhe Gjata” Nr.18,  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan  
Drejtoria e Spitalit, Elbasan

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 02.12.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e “Procedurë e hapur”, me nr. REF-80546-12-01-2020, me objekt “Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara”, me fond limit 20.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan.

II.2. Referuar informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se në datën 07.12.2020, është protokolluar pranë autoritetit kontraktor ankesa e operatorit ekonomik ankimes "Medi Tel" sh.p.k., i cili ka kërkuar modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit. Në ankesë pretendohet si më poshtë vijon:

[...]

*2.2 Operatori ekonomik Medi-tel shpk do te marre pjese ne kete procedure tenderimi publikuar ne adresen e [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) PROCEDURE E HAPUR SHERBIME me Objekti i kontrates: "Grumbullim, trajtim dhe asgjесim i mbetjeve spitalore - Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara;", Numri i references se procedures: REF-80546-17-01-2020, Fondi limit: 20.000.000,00 (njezet mi/ion) leke pa TVSH, por nga shqyrtimi kriterete te pjesmarrjes ne DST disa prej ketyre kriterete jane te paligjshem e ne shperpjесtim me objektin e tenderit. Konkretisht*

*1. Pika 2.1 Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike:*

*1. Objekti prokurimit jane mbetjet e rrezikshme spitalore si vijon: Operoret Ekonomike duhet te disponojne dhe te paraqesin:*

*1. Leje mjedisore te tipit B (me kod III.1.B) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) se bashku me Akt Miratimin perkates si dhe licencen profesionale perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) qe te perfshijne mbetje te rrezikshme me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjesimit te jete sterilizim me Autoklavim ose ekuivalente.*

*2. Leje Mjedisore tipi A (me kod III.LC), se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe licence Profesionale Perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore), qe te perfshijne mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjesimit te jete me incenerim.*

*a) Se pari i kerkojme AK te beje nje perlllogaritje te perafert ne kg per secilen kategori (kod mbetjesh) qe ata gjenerojne ne menyre qe ashtu si ne, por edhe cdo OE pjesemarrёs ne kete procedure tenderimi ta kete me te qarte perlllogaritjen e koston, dhe rrjedhimisht cmimin qe duhet te ofroje.*

*b) Se dyti i bejme me dije AK se duke tenderuar ne nje procedure te vetme, bashke me mbetjet infektive dhe anatomike, EDHE ato CITOSTATIKE DHE CITOTOKSIKE eshte duke favorizuar shoqeri te ndryshme qe kerkojne ta bejne monopol tregun dhe nuk i le hapёsire aspak shoqerive te cilat jane te licensuara nga organet kompetente per trajtimin vetem te mbetjeve citostatike dhe citotoksike respektivisht kodi 18 01 08 ose infektive dhe anatomike respektivisht 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03, 18 01 04. Vlen te theksojme se shoqeria MEDI-TEL shpk eshte shoqeria e pare e licensuar ne Republikёn e Shqiperise dhe me nje eksperience disa vjecare dhe brilante, nisur dhe nga eksperiencat personale qe QENDRA SPITALORE "XHAFERR KONGOLI" ka pasur me ne ne vitet e kaluar por shoqeria MEDI-TEL shpk eshte e licensuar vetem per trajtimin e mbetjeve me tipologji infektive dhe anatomike respektivisht qe ёsht 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03, 18 01 04. Por duke u vendosur nga AK nje kriter i tillё, i cili kerkon qe OE pjesemarrёs te jete i pajisur edhe me kodin 18 01 08 per mbetjet me tipologji citostatike dhe citotoksike,jo vetem qe na perjashton nga gara por favorizon haptazi shoqeri te tjera te cilat kerkojne te monopolizojne tregun, por edhe eliminon direkt nga gara dhe shoqeri te tjera shume serioze te cilat jane licensuar vetem per asgjesimin e mbetjeve citostatike dhe citotoksikedhe kimikateve shume te rrezikshme, por jo per ato infektive.*

Gjithashtu vlen te theksohet fakti qe sasia e mbetjeve me tipologji dhe citotoksike qe i perkasin kodit 18 01 08 qe QENDRA SPITALORE "XHAFERR KONGOLI" prodhon eshte e shume e vogel ne krahasim me tipologji te infektive apo anatomike.

Kriteri i mesiperme shkel:

- nenin 2 te LPP "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;

b) transparence ne procedurat e prokurimit;

c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve".

-Ne baze te nenit 23.1 te LPP "Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personat me aftest te kufizuara.

Persa i perket pikes:

Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe licence Profesionale Perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore), qe te perfshijne mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjesimit te jete me incenerim.

-nenin 46.1 te LPP qe percakton "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, se autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jo diskriminues: a) kualifikimi profesional; b) aftesia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare, · e) kapacitetet ligjore ".

Nisur nga sa me siper kerkojme perlllogaritjen e perafert (marre si reference sasite e viteve te kaluara) te sasive per cdo tipologji (kod) mbetjesh si dhe modifikim e ketij kriteri duke e ndare procedure ne LOTENE menyre qe te mos diskriminohet asnje OE, por perkundrazi te favorizohet cdo OE i cili eshte i licensuar nga organet kompetente per trajtimin e nje lloj mbetjeje te caktuar.

2. Pika 3.3 e kapacitetit teknik, ku thuhet:

Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 40% te fondit limit te vene ne dispozicion. Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:

a. Kur sherbimi i ngjashem eshte i realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate.

ose

b. kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat.

Nje kriter i tille eshte ne thelb diskriminues duke perjashtuar terthorazi nje Operator Ekonomik, ne rastin konkret, duke kerkuar ne menyre taksative Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vit 40% te fondit limit te vene ne dispozicion, ne kete menyre duke kategorizuar dhe perjashtuar cdo Operator Ekonomik i cili ka

pasur kontrata apo marreveshje kuader me afat jo me shume se 12 muaj dhe velera e perlllogaritur nuk ka qene asnjehere sa 40 % e nje vlere te perlllogaritur per 24 muaj. Gjithashtu, duke u nisur nga eksperiencat e mepareshme qe AK ka pasur ne gjithe vitet e shkuar, ku kontratat apo marreveshjet kuader i ka pasur me afat 12 muaj, kerkojme qe nga AK te modifikojte kete kriter duke kerkuar si deshmi sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 20% te fondit limit te vene ne dispozicion ose 40% e vleres se perlllogaritur per 12 muaj (10'000'000.00 lek pa TVSh). Pasi vendosja e nje kriteri te tille.

Per rrjedhoje ju drejtohem me kete ankese duke kerkuar nga ju ndermarjen e masave per modifikimin e nje kriteri perjashtues dhe diskriminues qe ne menyre decizive dhe jo te drejte perjashton bazuar ne keto cilesime. Ky kriter shkel:

nenin 46.1 te LPP qe percakton [...]

nenin 23.1 te LPP [...]

Duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi, te LPP dhe te te drejtave qe i njej Operatorit Ekonomik kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:

Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 20 % te fondit limit te vene ne dispozicion ose dispozicion ose 40 % e vleres se perlllogaritur per 12 muaj (1 0'000'000. 00 lek pa TVSh). Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte.:

a. Kur sherbimi i ngjashem eshte I realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate.

ose

b. kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat.

3. Pika 3.3.3 e kapacitetit teknik, ku thuhet:

3.Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem. Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese:

Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesirnin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper;

- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjeter teknik i secilit impiant dhe makinerise;

- Deklarate Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerise,

- Akt Miratimin Higjeno-Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shenim: KVO do te verifikojte ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga secili mpiant.

a) Per sa i perket pikes ku OE pjesemares duhet te kete te perfshire ne Lejen Mjedisore makine per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve ju bejme me dije se kerkesa e mesiperme eshte diskriminuese dhe pengon OE te marrin pjese ne prokurime mbi bazen e nje kerkese te paplote. Theksojme se OE MEDI-TEL shpk operon duke perdorur kontenitore plastike njeperdorimsh dhe si i tille pajisjen me impiant per larjen apo dezinfektimin e shikon totalisht te panevojshme, sepse kontenitoret qe kjo shoqeri perdor asgjesohen bashke me mbetjet dhe nuk ka asgje per tu lare apo dezinfektuar.

Ne keto kushte, AK nuk ka te drejte te vendose nje kerkese kaq diskriminuese, por duhet ta heqte ate ose ta zevendesoje me:

Kandidati/ofertuesi duhet tedorezoje:

-Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper, ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.

Kriteri i mesiperme shkel:

- nenin 2 te LPP "Perrqjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve:

b) transparence ne procedurat e prokurimit;

c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve".

\*-Gjithashtu, ju bejm me dije se makinat larese perfshihen ne Lejet Mjedisore Tipi C dhe se fundmi Lejet Mjedisore Tipi C jane hequr perfundimisht me Ligjin Nr. 52/2020 publikuar ne FLETOREN ZYRTARE te Republikes se Shqiperise date 28/05/2020 dhe Hyn ne fuqi 15 dite pas publikimit ne fletoren zyrtare, pra me date 12/06/2020.

b) Gjithashtu, ne pjesen ku AK kerkon qe OE pjesemarrës te paraqese Deklarate Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerise eshte diskriminues dhe i pabaze. Per sa kohe qe organi kompetet per pajisjen me Leje dhe Licence te nje impianti eshte Agjencia Kombetare e Mjedisit (AKM), nuk eshte detyra e AK te kerkoje dokumenta te kesaj natyre, pasi sic e thame me larte eshte AKM institucioni perkates qe kerkon te gjithë dokumentacionin e nevojshme per nje impiant perpara se sa ta pajise ate me Leje dhe Licence perkatese. Ne rasti nkonkret AK duhet te kerkoje vete dokumenta te cilat vertetojne nese impianti/impiantet e kerkuara te jene te pajisura me Leje dhe Licenca perkatese nga organet perkatese.

Per sa me siper kerkojme modifikim e ketij kriteri si me poshte:

- 3. Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetieve spitalore", (Rregulloria) si dhe makineri per larien dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem ose ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.

Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese:

Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

*-Impiantet për sterilizim /asgjësimin me incenerim duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose të jenë pasqyruar në Lejet Mjedisore të të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me sipër;*

*- Katalog ose skedë teknike ose çdo dokument tjetër teknik i secilit implant dhe makinerisë;*

*- Akt Miratimit Higjieno-Sanitar respektiv për implantet e autoklavimit dhe incenerimit të leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shëndetësor Shtetëror);*

*Shënim: KVO do të verifikojë në terren të dhenat për implantet të paraqitura nga ofertuesit si me sipër dhe realizimin e një cikli pune nga secili implant.*

*3. Pika 3.3.8 e kapacitetit teknik, ku thuhet:*

*8.Operatori duhet të furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 "Për administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:*

*-Kontenitor plastike njëpërdorimesh për të mprehtat 18 01 01: në 3 (tre) permasa që fillon nga 3 L deri 12 L*

*-Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmase njëpërdorimeshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) permasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për çdo permase, sipas Udhezuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.*

*- Kontenitor kartoni njëpërdorimesh me permase rreth 60 L për mbetje të buta 18 01 04*

*- Kontenitor të posaçëm njëpërdorimesh të kuq për mbetjet citostatike 18 01 08*

*Për të provuar plotësimin e këtij kriteri operatori duhet të paraqesë si pjesë të dokumentacionit në SPE, fature blerje ose zhdoganimi dhe Certifikimin e aprovimit të tipit të ambalazhit për secilin lloj kontenitori.*

*Operatori duhet të sjellë për verifikim në ambientet e Spitalit jo më vonë se dita dhe ora e hapjes së ofertave, nga një mostër për secilin lloj kontenitori.*

*Në lidhje me kërkesën për paraqitjen e "Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmase njëpërdorimeshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) permasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për çdo permase, sipas Udhezuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3." Një kriter i tillë është në thelb diskriminues duke përjashtuar terthorazi një Operator Ekonomik, në rastin konkret, duke kërkuar në mënyrë taksative që OE të paraqesë një mekanizëm hapje me pedale për çdo permase, pasi OE mund të disponojë/punojë (me) një formë karele të ndryshme nga kjo e kërkuar në DST. Duhet theksuar se karela në vetvete ben transportimin e kontenitoreve. Për më tepër mbajtësja metalike (karela) të cilës AK i referohet nuk ben mbyllje të sigurt të kapakut të kontenitoreve të mbetjeve (referuar të gjitha karelave të cilat bejne hapjen e kapakut me ane të pedanit), duke humbur kështu në teresi evitimin e kontaktit të personelit me mbetjet e infektuara. AK është e vetëdijshme se kontenitorët janë të pajisura me qese, cilat janë në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi, dhe duke marrë të mirëqenë faktin se punonjësit e spitalit respektojnë me rigorozitet të gjitha masat parandaluese (maske, doreza, dezinfektant, etj), si e tillë mundësia e kontaktit me pjesë të infektuara është e paperfillshme.*

*Ky kriter shkel: nenin 46.1 të LPP që percakton "Operatoret ekonomike, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim*

me natyren dhe permasat e kontrates qe dote prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftesia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; ç) kapacitetet ligjore nenin 23.1 te LPP "Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te perqatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plate objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidatëve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personat me aftest te kufizuara.

Nisur nga kjo kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:

8.Operatori duhet te furnizojë kontenitorët sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike nje perdorimesh per te mprehtat 18 01 01: ne 3 (tre) permasa qe fillon nga 3 L deri 12 L

- Kontenitor plastike te riperdorshem me qese plastmasi njeperdorimeshe, per mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, ne 3 (tre) permasa qe fillojne nga 30 L deri ne 60 L, shoqeruar me mbajtese metalike /karele me rrota, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.

-Kontenitor kartoni njeperdorimesh me permase rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04

- Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08.

II.3. Referuar dokumentacionit bashkëlidhur ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP, në datën 07.12.2020, me anë të shkresës nr.2222/1 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë. Konkretisht, autoriteti kontraktor ka argumentuar:

1. Ne lidhje me piken 1 te ankeses (Pika 2.1 Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike", Shtojca 8):

Se pari, OE ankimues kerkon qe nga ana e AK te behet nje perllogaritje e sasive per secilen kategori mbetjesh per te cilat prokurohet sherbimi i trajtimit/asgjesimit.

Ne kete drejtim sqarojme OE ankimues se kjo procedure eshte shpallur si Marreveshje Kuader, dhe si e tille, eshte e qarte se nga ana e AK motivimi baze per perzgjedhjen e kesaj forme procedure eshte pikerisht fakti qe eshte e veshtire, ne mos e pamundur qe te behet nje perllogarije paraprake e sasive te komponenteve te vecante te kategorive te mbetjeve.

Edhe APP ne Udhezimin nr. Nr. 6, date 16.01.2018 "PER PERDORIMIN E MARREVEESHJES KUADER DHE ZHVILLIMIN E SAJ ME MJETE ELEKTRONIKE" i ndryshuar, ne piken 3 ka percaktuar sa vijon:

3.1 Nje marreveshje kuader eshte e pershtatshme per mallra dhe sherbime te perdorura zakonisht me natyre te perseritur dhe/ose kur eshte e veshtire ose e pamundur per te percaktuar paraprakisht volumet qe duhet te prokurohen dhe nuk ka siguri per kohen e dorezimeve/realizimeve e te ekzekutimit te kontratave.

Ndryshimi ndermjet nje marreveshjeje kuader dhe kontratave te tjera qe lidhen sipas procedurave te prokurimit te parashikuara ne LPP eshte se kushtet e mallrave/sherbimeve/puneve, qe do te prokurohen, nuk jane te percaktuara ne nje marreveshje kuader. Autoritetet kontraktore mund te



blejne vetem per te plotesuar nevojat e tyre dhe jo per nevoja te autoriteteve kontraktore qe nuk jane pjese ne marreveshjen kuader.

3.2 Nje autoritet kontraktor perzgjedh realizimin e nje marreveshie kuader, kur ne kohen e zhvillimit te procedures se prokurimit:

a) ka nevoje per mallra dhe sherbime te perdorura zakonisht me natyre te perseritur dhe/ose;

b) eshte e pamundur te percaktohet objektivisht sasia/sasite e objektit te prokurimit ose elementeve te tij dhe/ose;

c) eshte e pamundur te percaktohet objektivisht data e sakte e dorezimit te mallit, punes, sherbimit ose pjeseve te tyre dhe/ose;

ç) eshte e pamundur te percaktohet objektivisht vendi i sakte i levrimit te mallit, punes, sherbimit, ose pjeseve te tyre dhe/ose;

d) eshte e pamundur te percaktohen nje ose disa kushte te tjera qe ndikojne ne realizimin e objektit te prokurimit dhe/ose;

dh) cmimet e tregut jane te paqendrueshme dhe per arsye teknike dhe teknologjike, objekti i kontrates (malli, puna, sherbimi) mund te dorezohet nga disa operatore ekonomike te suksesshem, gje qe e ben rihapjen e konkurimit me efektive per shkak te reduktimit te cmimit, sesa fillimin e nje procedure te re prokurimi.

Megjithate, ne funksion te permbushjes sa me shume te jete e mundur te kerkesave te OE te interesuar, pranohet kjo kerkese e OE ankimues dhe nje perllogaritje e perafert e sasive per cdo kategori mbetjesh do te publikohet si ndryshim ne Shtojcen 11 "Sherbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit", Sidoqofte keto volume mund te jene vetem te peraferta dhe nuk duhet te konsiderohen si definitive dhe te detyrueshme per tu levruar ne sasi ekzakte qe do te publikohen.

Se dyti, ne lidhje me kerkesen per ndarje ne lote te procedures, sqarojme se:

Ne kreun II, Neni 9, pika 5 e te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 914, date 29.12.2014 "Per I Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "Kontrata ndahet ne .1 LOTE, kur perbehet nga pune, mallra apo sherbime, homogjene ose te ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar eshte e tille qe vetem nje numer i vogel operatoresh ekonomike do te ishin ne gjendje t 'i siguronin ato. Kjo menyre mund te perdoret vecanerisht per te nxitur pjesemarrjen e biznesit, te vogel e te mesem, apo per te ulur kostot administrative te autoritetit kontraktor. "

NeVendimin te Keshillit te Ministrave Nr. 798, date 29.09.2010 "Per miratimin e rregullores per administrimin e mbetjeve spitalore", ne Kreun I, pika 1 dhe 2 Qellimi dhe Objekti, percaktohet: "Kjo rregullore percakton procedurat, rregullat dhe standardet teknike per administrimin e mbetjeve spitalore me qellim mbrojtjen e shendetit publik dhe te mjedisit ". a) "Mbetje spitalore" Jane mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku perfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe Jo te rrezikshme, te cilat renditen ne paragrafin 18 te vendimit nr.99, date 18.2.2005 te vendimit te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e Katalogut Shqiptar te Klasifikimit te Mbetjeve ". k) "Mbetje e rrezikshme" perfshijne mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretes te infektuar ".

Ndarja ne Lote e kesaj procedure prokurimi me Lot me vete per kategorite e ndryshme te mbetjeve, jo vetem nuk eshte e justifikuar nga Neni 9, pika 5 e VKM Nr. 914, date 29.12.2014 "Per Rregullat e Prokurimit Publik", por edhe do te komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shperndarjen e pergjegjesive duke e komplikuar edhe realizimin me sukses te kontrates, Ky eshte nje sherbim qe nga ana jone kerkohet te merret si nje sherbim i integruar, pasi perfshirja eventuale e disa OE per

evadimin e kategorive te vecanta mbetjesh do te ishte pothuajse e pamundur per tu menaxhuar, do te krijonte kaos, kosto te rritura dhe rrezik te shtuar per ambientet dhe stafin spitalor.

Ky qendrim eshte mbajtur edhe nga KPP ne Vendimet si vijon: nr.835/2018, nr.98/2019, nr.14/2019 dhe nr.54/2019 dhe Vendimet e KPP jane administrativisht perfundimtare. Vlen te theksojme se kjo kerkese e OE ankimues, ne kushtet kur ka vendime te KPP per mosndarjen ne lote, vetem sa krijon pengesa dhe vonesa artificiale per zhvillimin e procedures, per kete sherbim kaq te domosdoshem dhe sensitiv, vecanerisht ne kete kohe me risqe te shtuara per shkak te pandemise COVID- 19.

Se treti, per sa i perket pretendimit te OE ankimues se trajtimi i mbetjeve citostatike dhe citotoksike (18 01 08) duhet te ndahet si lot me vete, pasi e perjashton ate nga gara, nuk mund te jete shkak per te here ndarjen ne tote, pasi prioriteti i AK eshte realizimi i sherbimit dhe jo krijimi i kushteve per te mundesuar pjesemarrjen e nje OE te caktuar.

Nga ana tjeter, na rezulton, se ju si OE ankimues keni marre pjese, jeni kontraktuar dhe keni zbatuar minimalisht nje kontrate tjeter qe perfshin asgjesimin e mbetjeve citostatike dhe citotoksike (18 01 08), ne proceduren e realizuar nga Spitali Rajonal Durres me nr.REF-95737-11-23-2018, me objekt "Transport dhe asgjesim i mbetjeve te rrezikshme spitalore KODI:18 01 02; 18 01 09; 18 01 08". Pra, ose ky pretendim juaji eshte ngritur ne menyre te vetedijshme artificialisht nga ana juaj, ose ne zbatimin e kontrates se mesiperme nuk keni pasur licensimet e kerkuara nga ligji dhe keni operuar i papajisur me lejet dhe licensat perkatese.

Per sa me siper, kerkesa perndarjen ne lote te procedures nuk pranohet.

2. Ne lidhje me piken 2 te ankeses (Pika 3.3 e Kapacitetit teknik", Shtojca 8):

OE ankimues kerkon qe te pergjysmohet nga ana e AK vlera e kerkuar per kontrata te ngjashme te realizuara.

Sqarojme se ky kriter eshte percaktuar plotesisht ne perputhje me piken 3 te nenit 28 te VKM nr.914, date 29.12.2014, "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", qe percakton se: "Per te provuar pervojen e meparshme, autoriteti kontraktor kerkon deshmi per sherbimet e meparshme, te ngjashme, te kryera gjate tri viteve te fundit. Ne cdo rast, vlera e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tri viteve te fundit. "

Per sa kohe, qe kjo dispozite percakton limitin prej 40% te vleres se perlllogaritur te kontrates dhe ky limit eshte respektuar nga ana e AK, si dhe nisur nga fakti qe ky objekt prokurimi, eshte nje nga sherbimet me sensitive dhe qe kerkon reputacion, besueshmeri dhe standarte te larta nga OE konkurues, ky kriter rezulton qeeshte i sakte, I ligjshem dhe proporcional.

Per sa me siper ankesa e OE ankimues per kete pike nuk pranohet

3. Ne lidhje me piken 3 te ankeses (Pika 3.3.3 e Kapacitetit teknik, Shtojca 8):

Se pari, ne lidhje me pretendimin e OE ankimues se kerkesa per te dsiponuar makineri per larjen dhe pastrimin e kontenitoreve eshte e panevojshme dhe ose duhet te hiqet, ose duhet te pranohet vetedeklarim nga OE konkurues qe kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimesh, sqarojme se:

Ne Shtojcen nr.9 te Dokumentave te Tenderit, ne piken 9 eshte percaktuar qe:

Operatori Ekonomik duhet te furnizojte me konteniere AK sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 814 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

1. Kontenitor plastike njeperdorimesh per te mprehtat 18 01 01: ne 3 (tre) permase qe fillon nga 3 L deri 12 L

2. Kontenitor plastike te riperdorshem me qese plastmasi njeperdorimeshe, per mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, ne 3 (tre) permase qe fillojne nga 30 L deri ne 60 L, shoqeruar me mekanizem hapje me pedale per cdo permase, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.

3. Kontenitor kartoni njeperdorimesh me permase rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04

4. Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08

Sqarojme se AK, ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, ka parashikuar qe ne dallim nga kontenitoret per te mprehtat dhe qeset dhe ato te posacmit per citostatiket, qe jane amballazhi i drejtperdrejte i mbetjeve spitalore qe duhet te jene njeperdorirneshe, kontenitoret plastike te medhenj qe duhet te vihen ne dispozicion nga Operatori Ekonomik fitues qe sherbejne per transferimin dhe transportin e mbetjeve spitalore, duhet te jene shumeperdorimesh dhe kjo nuk eshte nje zgjedhje subjektive e AK, por e ndikuar nga shkaqet ligjore, ekonomike dhe mjedisore si vijon:

1. Dispozitat ligjore ne fuqi per mbrojtjen e mjedisit dhe ato per menaxhimin e integruar te mbetjeve kane percaktuar qarte se parimet dhe hierarkia e menaxhimit te mbetjeve duhet te jete e tille qe te synoje sa me shume te jete e mundur parandalimin, riperdorimin, riciklimin, etj, dhe te pranoje asgjesimin vetem si alternative te fundit. Me konkretisht:

Ligji nr.10 463 date 22.9.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", .ne nenin 6 ka percaktuar qe: "1. Percaktimi i perparësive ne ligje, strategji, plane dhe programe te menaxhimit te integruar te mbetjeve te trasheguara apo te atyre qe krijohen behet duke pasur parasysh hierarkine e meposhtme: a) parandalimin e mbetjeve; b) pergatitjen per riperdorim; c) riciklimin; ç) rikuperime te tjera; d) asgjesimin. 2. Per percaktimin e kesaj hierarkie mbahen parasysh parimet e pergjithshme per mbrojtjen e mjedisit, te percaktuara ne nenet 6-14 te ligjit nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" dhe kerkesat e tjera te ketij ligji. 3. Ne rastet e zbatimit te hierarkise se menaxhimit te integruar te mbetjeve, te percaktuara ne piken 1 te ketij neni, ministria dhe te gjitha autoritetet perkatese marrin masa per te nxitur opsionet me rezultatet e pergjithshme me te mirat ne mjedis. 4. Aktet nenligjore te vecanta per rryma te vecanta mbetjesh bazohen ne hierarkine e percaktuar ne piken 1 te ketij neni, kur nje gje e tille justifikohet nga analiza e ciklit te kohezgjatjes se ndikimeve te pergjithshme, qe vijne nga krijimi dhe menaxhimi i ketyre mbetjeve, ne menyre qe te perftohet rezultati i pergjithshem me i mire per mjedisin."

Ligji nr. 10 431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit" percakton sa vijon:

Neni 7 pg. 1 "Masat per mbrojtjen e mjedisit merren ne nje faze te hershme te zhvillimit te cdo veprimtarie, ne menyre qe te parandalojne apo, ne rast se nuk eshte e mundur, te minimizojne efektet negative te asaj veprimtarie ne mjedis."

Neni 33 pg.1 "Menaxhimi i integruar i mbetjeve synon parandalimin ose reduktimin e mbetjeve dhe ndikimeve te demshme te tyre mbi mjedisin, si dhe perdorimin e efektshem te burimeve natyrore, me qellim mbrojtjen e mjedisit, te burimeve, te shendetit te njeriut, si dhe permiresimin e cilesise se jetes."

Kerkesat per parandalimin e krijimit te mbetjeve dhe minimizimin e tyre jane percaktuar ne menyre specifike edhe ne Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore i nxjerre ne zbatim te VKM Nr. 798, date 29.09.2010, ne te cilin percaktohet sa vijon:

*Ne piken 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit te mbetjeve:*

*Parimet e mira te administrimit te mbetjeve perfshijne:*

- *minimizim i prodhimit te mbetjeve*
- *rregullim i ndarjes se mbetjeve ne burim sipas te cilit mbetjet e destinuar per menyra te*
- *ndryshme trajtimi dhe asgjesimi ndahen ne "rryma" te ndryshme;*
- *udhezim dhe trajnim i personelit lidhur me rregullimn e ndarjes se mbetjeve ne burim dhe*
- *motivimi i tyre per te siguruar se ndarja eshte efektive;*
- *organizim i trajtimit dhe i asgjesimit te mbetjeve ne menyren e duhur per cdo rryme;*
- *mbajtje e regjistrave;*
- *monitorim i performances se organizimit te ndarjes ne burim dhe asgjesimit;*
- *marrje e masave korrigjuese nese eshte e nevojshme.*

*Pra, AK ne planifikimin e menaxhimit te mbetjeve spitalore, duke kerkuar konteniere plastike qe mund te riperdoren, ka zbatuar pikerisht parimin e "minimizimit te prodhimit te mbetjeve", pasi nese do te pranonte konteniere njeperdorimesh qe duhet te asgjesohen pas cdo perdorimi se bashku me mbetjet spitalore, do te shtonte me shumefisha volumin e mbetjeve qe shkojne per asgjesim, dhe kjo do te ishte ne kundërshtim me te gjitha parimet e sipercituara.*

*Ne piken 8.2.2 (faqe 25 - 26) te Udhezuesit se bashku me foton ilustruese - Karrocat e perdorura per transferimin e mbetjeve spitalore:*

*Për transferimin e mbetjeve spitalore në godina, duhet të përdoren karroca të caktuara për këtë funksion. Ato duhet të projektohen dhe ndërtohen në përputhje me specifikimet e mëposhtme:*

- *Sipërfaqet duhet të jenë të buta, pa tehe të mprehta ose të ashpra (që mund të dëmtojnë ambalazhin e mbetjeve spitalore);*
- *Duhet të përdoren materiale të papërshkueshme dhe projektimi duhet të sigurojë kontrollin e çdo derdhje të mbetjeve që mund të ndodhë në tranzit;*
- *Karrocat duhet të jenë të tilla që të pastrohen dhe kullohen lehtë, dhe*
- *Modelimi i përgjithshëm duhet të lejojë që qeset dhe kontenierët të mbahen siç duhet në karroca, dhe të ngarkohen/shkarkohen në mënyrë të sigurtë dhe manipulohen pa vështirësi.*

*Karrocat duhet të pastrohen në fund të çdo dite pune dhe të dezinfektohen tërësisht në intervale të rregullta.*



*Foto 10. Idealisht, mbetjet duhet të transportohen në konteniere prej plastike të durueshme dhe me rrota*

*Ne piken 9.1 (faqe 28 - 29) te Udhezuesit - Sherbimi i grumbullimit*

*Grumbullimi i mbetjeve spitalore duhet të kryhet nga subjekt i licencuar në përputhje me kërkesat e specifikuara në licencat për grumbullimin e mbetjeve dhe në përputhje të plotë me Rregulloren. Koshat/kontenierët tranzit të specifikuar në seksionin 9.3.1 të këtij Udhëzuesi duhet të përdoren për grumbullimin e mbetjeve spitalore nga prodhuesit e mbetjeve. Grumbulluesit e licencuar duhet të kontrollojnë dhe sigurojnë ambalazhimin, mbylljen dhe etiketimin e duhur të kontenierëve të mbetjeve në lidhje me kërkesat përkatëse të përcaktuara në këtë Udhëzues para vendosjes së tyre në koshat/kontenierët tranzit. Mbetjet spitalore si indet njerëzore dhe ato shtazore duhet të vendosen në kosha/kontenierë tranzit për këtë qëllim, pa i përzier me mbetjet e tjera spitalore. Nëse mbetjet spitalore janë vendosur në koshat/kontenierët tranzit që gjatë magazinimit nga prodhuesit e mbetjeve, grumbulluesit e licencuar duhet që para grumbullimit të koshave/kontenierëve tranzit, të sigurohen se ata janë të mbyllur mirë dhe etiketuar siç duhet, sipas seksionit 9.3.1 të këtij Udhëzuesi.*

*Ne piken 9.3.1 (faqe 29 - 30) te Udhezuesit - Koshat/kontenieret tranzit*

*Çdo kosh/kontenier për mbetjet spitalore përveç atyre që kërkojnë ruajtje në frigorifer duhet të ketë shënimin "MBETJEVE SPITALORE" në Shqip" dhe HEALTHCARE ËASTE" në Anglisht, me lartësi minimale prej 40 mm dhe në ngjyrë të ZEZE, ndërsa për mbetjet spitalore që kërkojnë ruajtje në frigorifer duhet të ketë shënimin "MBETJEVE SPITALORE PER FRIGORIFER " në Shqip dhe "HEALTHCARE ËASTE FOR REFRIGERATION" në Anglisht, si dhe shenjën ndërkombëtare të bio-hazardit e dhënë në Shtojcën G me një lartësi minimale prej 240 mm në ngjyrë të ZEZE. Koshat/kontenierët tranzit për indet njerëzore dhe shtazore duhet të jetë në ngjyrë të VERDHË ose të ketë një etiketë të dallueshme në të VERDHË për të lehtësuar identifikimin e mbetjeve. Çdo kosh/kontenier duhet të ketë një numër serial unik që duhet të shfaqet në shifra të dallueshme në ngjyrë të ZEZE dhe/ose germa për identifikim të lehtë dhe për qëllim regjistrimi.*

*Koshat/kontenierët tranzit duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:*

- Të shërbejnë vetëm për qëllim të ruajtjes së mbetjeve spitalore të paketuara;*
- Të jenë të pajisur me kapak dhe të mbyllën shumë mirë;*
- Të mos lejojnë derdhjen e përmbajtjes dhe depërtimin e shiut përmes kapakut apo mbulesës;*
- Të mos lejojnë strehimin e insekteve dhe parazitëve dhe grumbullimin e mbetjeve spitalore në anët apo në çarjet, etj;*
- Të jenë të tipit për shumë-udhëtime dhe të ripërdorueshëm; dhe*
- Të mund të dezinfektohen ose dekontaminohen me avull.*

*Gjithashtu, vlen të përmendim se në piken 3 "Koshat plastike" te Shtojcës E "Specifikimet për kontenieret e mbetjeve spitalore" te Udhezuesit, ndër të tjera është përcaktuar që: "Keta konteniere duhet të inspektohen pas çdo përdorimi për të siguruar që janë të pastër, të pademtuar dhe pa rrjedhje. Çdo kontenier i demtuar duhet të riparohet para se të përdoret ose të hiqet nga përdorimi. Pjesa e brendshme duhet të jete e lemuar dhe e papershkueshme që të mbaje ndonjë derdhje dhe që të mund të inspektohen, pastrohen dhe higjienizohen lehtësisht."*

*Nga përcaktimet e mesiperme, është e qarte se kërkesa e AK për konteniere plastike shumëpërdorimesh është jo vetëm e logjikshme, por edhe e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore dhe nenligjore në fuqi.*

2. Pretendimi i OE ankimues se mund te ofrohen konteniere plastike njeperdorimesh nuk eshte i pranueshern dhe eshte jorealiste, sepse AK e ka perlllogaritur fondin limit duke mbajtur ne konsiderate edhe llogjiken ekonomike te riperdorimit te konteniereve plastike pasi jane pastruar e higjenizuar.

Per ta permbledhur, duke iu referuar pervesojes aktuale te AK por edhe spitaleve te tjera, mesatarisht ne nje jave evadohen rreth 100 kosha plastike te medhenj. Cikli mesatar i jetes per nje kosh te tille eshte rreth 6 muaj. Pra, per nje periudhe 2 vjcare, eshte perlllogaritur furnizimi me rreth 400 kosha te medhenj.

Ndersa po te pranonim llogjiken e OE ankimues per kosha/konteniere plastike njeperdorimesh do duhej te ishin llogaritur ne kostot per tu perballuar nga OE nje sasi mesatare prej 10.400 kosha te medhenj (26 here me shume se sasia me riperdorim). Duhet te mbajme ne konsiderate ne kete rast se nese kontenieret plastike do te asgjesohen (ne incenerator ose ne landfill) pas cdo perdorimi, i bie qe per 2 vjet AK te promovojte rritjen me minimalisht 26 here te sasise se plastikes qe dergohet per asgjesim dhe kjo do te ishte nje rritje kolosale e ndotjes mjedisore dhe ne kundertshtim me te gjitha parimet e mbrojtjes se mjedisit dhe menaxhimit te integruar te mbetjeve te cituara me lart.

Nese do te pranohej kerkesa e OE ankimues jo vetem do te ishte ndryshim thelbesor i konceptimit te kerkesave teknike te AK, por do te ishte gjithashtu ne kundertshtim me dispozitat e sipercituara dhe do te ishte promovim nga AK i rritjes se ndotjes se mjedisit.

Ne rrethanat e mesiperme, eshte plotesisht e argumentuar vendosja e kerkeses qe OE te disponojte makineri per laren dhe pastrimin e konteniereve, Gjithashtu, ndryshe nga sa pretendon OE ankimues, eshte e bazuar edhe kerkesa qe kjo te jete e perfshire ne lejen mjedisore, pasi vertet me ndryshimet e ligjit "Per Lejet e Mjedisit" jane hequr Lejet mjedisore te tipit C me kod (III.1.A), por nuk eshte hequr detyrimi qe aktiviteti i "larjes dhe pastrimit te konteniereve qe mund te riperdoren" te pajiset me leje mjedisore, pasi thjesht eshte transferuar ky detyrim ne Lejet Mjedisore te Tipit A (kod III.1.C) dhe tipit B (III. 1.B).

Pra, sic u sqarua ne detaje me siper pastrimi, larja, madje edhe dizinfektimi i konteniereve ne menyre qe te riperdoren eshte jo vetern pjese e elementeve te sherbimit qe OE duhet te ofrojne, por eshte edhe percaktim i dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi qe kontenieret duhet te riperdoren dhe per kete qellim duhet te pastrohen e lahen pas cdo riperdorimi.

Per sa me siper, pretendimi i ankimuesit per kete pike nuk qendron.

Se dyti, per sa i perket pretendimit te OE ankimues qe te hiqet kerkesa per paraqitjen e Deklarates se Konformitetit CE per impiantet, vleresojme fillimisht te sqarojme, se sherbimi i kerkuar ka nje natyre mjaft delikate dhe per te kerkohen standarte maksimale, pasi pervecse eshte nje sherbim i disiplinuar me nje sere lejesh e licensash, eshte gjithashtu i rregulluar ne menyre te detajuar me akte ligjore dhe nenligjore dhe madje standartet e tij kane nje vemendje te posacme edhe nga rregullat dhe procedurat e OBSH. Kriteret e vendosura nga ana jone jane bazuar ne:

- Nenin 46 te LPP dhe piken 5 te nenit 28 te RRPP, duke vleresuar si mjaft te rendesishme per kete sherbim kaq delikat qe OE pjesemarres te deshmojne se nder te tjera zoterojne edhe "kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative...reputacionin dhe besueshmerine, pervesojen e duhur..... " si dhe ne nenin 28 te Rregullave te Prokurimit Publik.

- Eksperienat e meparshme tonat dhe te autoriteteve te tjera me kete lloj sherbimi;

- Ndjeshmerine e larte dhe ndikimin e ketij sherbimi ne jeten dhe shendetin e qytetareve; dhe

- Ne faktin se mangesite ne standarte nga operatore te ndryshem te ketij sherbimi kane qene vazhdimisht shqetesim per autoritetet shendetesore, pacientet dhe shpesh jane percjelle edhe ne media;

- Vecanerisht ne kete periudhe mjaft te ndjeshme per shendetin publik per shkak te rreziqeve epidemiologjike, eshte e rendesishme qe te mos tolerohet asnje cedis ne kapacitetet e sa me te sigurta teknike qe kerkohet te kene ofruesit e ketij sherbimi dhe duhet mbajtur parasysh se reputacioni dhe besueshmeria kerkojne qe operoret e sherbimit te demonstrojne nje nivel te caktuar qendrueshmerie ne drejtim te krijimit dhe ruajtjes se kapacitetive profesionale.

Gjithashtu, vendosja e kesaj kerkese eshte ne perputhje me ligjin nr.10 489, date 15.12.2011 "PER TREGTIMIN DHE MBIKEQYRJEN E TREGUT TE PRODUKTEVE JOUSHQIMORE", i cili rregullon ne menyre te posacme nevojen e pasjes se Deklarates se Konformitetit EC, si kusht per vendosjen ne treg dhe instalimin e produkteve industrial, vecanerisht impiante qe disiplinohen me rregulla teknike te posacme sic jane impiantet qe punojne me lende djegese, me avull, me presion, apo me sisteme elektrike.

Per sa me siper, pretendimi i ankimuesit per kete pike nuk qendron.

4. Ne lidhje me piken 4 te ankeses (Pika 3.3.8 e Kapacitetit teknik, Shtojca 8):

OE ankimues pretendon qe te hiqet kerkesa per opsionin e pedales per kontenieret e medhenj.

AK pervec te tjerave, per hartimin e kerkeseve teknike eshte mbeshtetur ne Udhezuesin Kombetar per Administrimin e Sigurt te Mbetjeve Spitalore i nxjerre ne zbatim te VKM Nr. 798, date 29.09.2010. Ky Udhezues percakton ne menyre te detajuar ne piken 7.2.3 (fq.23), se bashku me fotot ilustruese (Foto 8 - preferenca per pedal) si dhe ne piken 9.3.1 te Udhezuesit (fq.29 - 31) se koshat e me pedal jane model i perzgjedhur per te garantuar sigurine dhe mbrojtjen maksimale nga ndotja dhe perhapja e mbetjeve dhe patogjeneve, gjate procesit te levizjes dhe perpunimit te tyre, pasi evitohet perdorimin dhe manipulimin e mbetjeve brenda tyre me duar, si dhe realizojne nje distance te sigurte te rrugeve respiratore te njerezve qe punojne me to, pasi mund ti operojne vetem me kembe.

Per sa me siper, pretendimi i ankimuesit nuk qendron.

II.4. Në datën 14.12.2020 operatori ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar si më poshtë vijon:

[...]

1. Pika 2.1 Kapaciteti ligjor i operatoreve ekonomike:

1. Objekti prokurimit jane mbetjet e rrezikshrne spitalore si vijon: Operoret Ekonornike duhet te disponojne dhe te paraqesin:

1. Leje mjedisore te tipit B (me kod III. LB) ose Leje Mjedisore te tipit A (me kod III.1.C) se bashku me Akt Miratimin perkates si dhe licencen profesionale perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme Spitalore) qe te perfshijne mbetje te rrezikshrne me kod 18 01 01; 18 01 03; 18 01 04, ku procedura e asgjesimit te jete sterilizim me Autoklavim ose ekuivalente.

2. Leje Mjedisore tipi A (me kod III.1.C), se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe licence Profesionale Perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore), qe te perfshijne mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjesimit te jete me incenerim.

*Ne si OE i bejme me dije AK se duke tenderuar ne nje procedure te vetme, bashke me mbetjet infektive dhe anatomike, EDHE ato "CITOSTATIKEDHE CITOTOKSIKE"eshte duke favorizuar shoqeri te ndryshme qe kerkojne ta bejne monopol tregun dhe nuk i le hapesine aspak shoqerive te cilat jane te licensuara nga organet kompetente per trajtimin vetem te mbetjeve citostatike dhe citotoksike respektivisht kodi 18 01 08 ose infektive dhe anatomike respektivisht 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03, 18 01 04. Vlen te theksojme se shoqeria MEDI-TEL shpk eshte shoqeria e pare e licensuar ne Republiken e Shqiperise dhe me nje eksperience disa vjecare dhe brilnte, nisur dhe nga eksperiencat personale qe QENDRA SPITALORE "XHAFERR KONGOLI" ka pasur me ne ne vitet e kaluar.*

*Gjithashtu shoqeria MEDI-TEL shpk eshte e licensuar per trajtimin e mbetjeve me tipologji infektive, anatomike dhe shume tipologji mbetjesh te tjera, respektivisht 18 01 01, 18 01 02, 18 01 03, 18 01 04, 18 01 08, 18 01 09 etj. Respektivisht me 3 (tre) Leje Mjedisore dhe Licenca perkatese, si dhe akt-marreveshje me nje prej kompanive lider ne Europe per trajtimin dhe asgjesimin e mbetjeve me tipologji KIMIKATE dhe Citostatike. Nisur nga kjo Shoqeria jone per te bere nje pune sa me cilesore dhe ta beje ate si cdo vend me i zhvilluar Europian, ku mund te permendim vende si Suedi, Gjermani, Finlanda,Greqi, Norvegjia, Belgjika, Zvicra, etj, trajtimin apo asgjesimin e mbetjeve me tipologji KIMIKATE dhe CITOSTATIKE/CITOTOKSIKE e ben duke i derguar keto lloj mbetjesh per trajtim/asgjesim ne keto vende te zhvilluar dhe duke garantuar keshtu trajtimin apo asgjesimin e tyre me menyra me te sofistikuara, qe ketu ne vendin tone jo vetem qe nuk i ofron asnje shoqeri tjeter,por per hir te se vertetes jane shume larg dhe operojne akoma me teknologji apo pajisje primitive. Per sa me siper, duke u vendosur nga AK nje kriter i tille, i cili kerkon qe OE pjesemarrës te jete i pajisur me te gjithë kodet perkatese, duke bere bashke ato me tipologji infektive dhe ato me tipologji citostatike dhe citotoksike, jo vetem qe eshte diskriminues par favorizon haptazi shoqeri te tjera te cilat kerkojne te monopolizojne tregun, por edhe eleminon direkt nga gara dhe shoqeri te tjera shume serioze te cilat jane licensuar vetem per asgjesimin e mbetjeve citostatike dhe citotoksike dhe kimikateve shume te rrezikshme, por jo per ato infektive.*

*Gjithashtu vlen te theksohet fakti qe sasia e mbetjeve me tipologji dhe citotoksike qe i perkasin kodit 18 01 08 qe QENDRA SPITALORE "XHAFERR KONGOLI" prodhon eshte e shume e vogel ne krahasim me tipologji te infektive apo anatomike.*

*Kriteri i mesiperme shkel:*

*- nenin 2 te LPP "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:*

*a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;*

*b) transparence ne procedurat e prokurimit;*

*c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesveose kandidateve".*

*-Ne baze te nenit 23.1 te LPP "Specifikimet teknike, qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te perqatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithë kandidateve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specififikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te ti/le qe te kuptohen nga personat me aftesi te kufizuara.*

*Persa i perket pikes:*



*Leje Mjedisore tipi A (me kod III.L.C), se bashku me Akt Miratimin perkates, si dhe licence Profesionale Perkatese te kategorise III.2.B (Per trajtimin e mbetjeve te rrezikshme spitalore), qe te perfshijne mbetjet me kod 18 01 02, 18 01 08 dhe 18 01 09 ku procedura e asgjesimit te jete me incenerim.*

*-nenin 46.1 te LPP qe percakton "Operatorete ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjasetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftesia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; f) kapacitetet ligjore "*

*Nisur nga sa me sipër kerkojme modifikim e ketij kriteri diskriminues, duke e ndare proceduren ne lote ne menyre qe te shmangen hapesirat per favorizimin e vetem nje OE te cakuar, i cili kerkon ta ktheje tregun ne momopol dhe eliminimin eOE te tjere te cilet edhe pse jane te licensuar nga organet kompetente me te gjitha dokumentacionin perkates, i eliminon ky kriter kaq diskriminues.*

*2. Pika 3.3 e kapacitetit teknik, ku thuhet:*

*Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 40% te fondit limit te vene ne dispozicion. Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:*

*a. Kur sherbimi i ngjashem eshte i realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate.*

*ose*

*b. kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat. Nje kriter i tille eshte ne thelb diskriminues duke perjashtuar terthorazi nje Operator Ekonomik, ne rastin konkret, duke kerkuar ne menyre taksative Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 40 % te fondit limit te vene ne dispozicion, ne kete menyre duke kategorizuar dhe perjashtuar cdo Operator Ekonomik i cili ka pasur kontrata apo marreveshje kuader me afat jo me shume se 12 muaj dhe vlere e perlllogaritur nuk ka qene asnjehere sa 40 % e nje vlere te perlllogaritur epr 24 muaj. Gjithashtu, duke u nisur nga eksperiencat e meparshme qe AK ka pasur ne gjithë vitet e shkuar, ku kontratat apo marreveshjet kuader i ka pasur me afat 12 muaj, kerkojme qe nga AK te modifikojte kete kriter duke kerkuar si deshmi sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 20 % te fondit limit te vene ne dispozicion ose 40 % e vleres se perlllogasritur per 12 muaj (1 0'000'000.00 lek pa TVSh). Pasi vendosja e nje kriteri te tille.*

*Per rrjedhoje ju drejtohem me kete ankese duke kerkuar nga ju ndermarjen e masave per modifikimin e nje kriteri perjashtues dhe diskriminues qe ne menyre decizive dhe jo te drejte perjashton bazuar ne keto cilesime. Ky kriter shkel:*

*-nenin 46.1 te LPP qe percakton "Operatorete ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjasetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftesia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; ç) kapacitetet ligjore*

nenin 23.1 te LPP "Specifikimet teknike qe percaktojne karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plate obiekten e prokurimit duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personal me aftest te kufizuara.

Duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi, te LPP dhe te te drejtave qe i njeh Operatorit Ekonomik kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:

Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 20 % te fondit limit te vene ne dispozicion ose dispozicion ose 40 % e vleres se perllogasritur per 12 muaj (1 0'000'000. 00 lek pa TVSh). Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:.

a. Kur sherbimi i ngjashem eshte I realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar naa institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate.

ose

b. kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat.

3. Pika 3.3.3 e kapacitetit teknik, ku thuhet:

3.Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem. Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese:

Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper;

- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjeter teknik i secilit impiant dhe makinerise;

- Deklarate Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerise,

- Akt Miratimin Higjeno-Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shenim: KVO do te verifikojë ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga secili mpiant.

a) Per sa i perket pikes ku OE pjesemares duhet te kete te perfshire ne Lejen Mjedisore makine per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve ju bejme me dije se kerkesa e mesiperme eshte diskriminuese dhe pengon OE te marrin pjese ne prokurime mbi bazen e nje kerkese te paplote.

I sjellim ne vemendje AK se Makinerite per larjen, spurcimin, dezinfektimin e kontenitoreve, (makinat lerese) nuk perfshihen ne Lejet Mejdimore Tipi B apo A, por ato perfshiheshin ne Lejet Mejdimore Tipi C, te cilat jane hequr perfundimisht me Ligjin Nr. 52/2020.

*Theksojme se OE MEDI-TEL shpk operon duke perdorur kontenitore plastike njeperdorimsh dhe si i tille pajisjen me impiant per larjen apo dezinfektimin e shikon totalisht te panevojshme, sepse kontenitoret qe kjo shoqeri perdor asgjesohen bashke me mbetjet dhe nuk ka asgje per tu lare apo dezinfektuar.*

*Ne keto kushte, AK nuk ka te drejte te vendose nje kerkese kaq diskriminues, por duhet ta heqe ate ose ta zevendesoje me:*

*Kandidati/ofertuesi duhet tedorezoje:*

*- Impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper, ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.*

*Kriteri i mesiperme shkel:*

*- nenin 2 te LPP "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:*

*a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;*

*b) transparence ne procedurat e prokurimit;*

*c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve"*

*-Lidhur me pretendimet e AK se ky kriter eshte vendosur per te mbrojtur mjedisin dhe se ka zbatuar piken 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit te mbetjeve, ju bejme me dije se pika 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit te mbetjeve i referohet minimizimit te prodhimit te mbetjeve nga prodhuesit e tyre, ne kete rast minimizimin e mbetjeve qe gjenerohen nga Qendra Spitalore XHAFERR KONGOLI Elbasan dhe ska lidhje me menyren e asgjesimit apo me llojin e kontenitoreve qe perdoren.*

*-Perseri, ju bejme me dijeni se OE MEDI-TEL shpk per te reduktuar ne pothuajse 0 (zero) emetime e gazrave te demshem ne atmosfere, prej muajit Mars 2020 ka investuar dhe eshte pajisur me nje incenerator te teknologjise se fundit "MEDIBURN 30", gje e cila ka ndikim te drejtperdrejte me mjedisin duke e permiresuar djegien deri ne ate nivel sa eshte e paperfillshme per mjedisin.*

*\*-Gjithashtu, se fundmi Lejet Mjedisore Tipi C jane hequr perfundimisht me Ligjin Nr. 52/2020 publikuar ne FLETOREN ZYRTARE te Republikes se Shqiperise date 28/05/2020 dhe Hyn ne fuqi 15 dite pas publikimit ne fletronen zyrtare, pra me date 12/06/2020.*

*Per nje kriter te tille ka dhe nje vendim te Komisionit te Prokurimit Publik (KPP) nr. 251/2020, i cili nuk pranon vendosjen e nje kriteri te tille.*

*Per sa me siper kerkojme modifikim e ketij kriteri si me poshte:*

*- 3. Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per traitimin me sterilizim / asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetieve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregulloria) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem ose ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.*

*Per te vertetuar permbushien e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese:*

*Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);*

- Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesisimin me incenerim duhet te jene te pajisur me Leie Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper;

- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tieter teknik i secilit impiant dhe makinerise.

- Akt Miratimin Higjeno-Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shenim: KVO do te verifikojte ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga seicili impiant.

3. Pika 3.3.8 e kapacitetit teknik, ku thuhet:

8.Operatori duhet te furnizojte kontenitoret sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike njeperdorimesh per te mprehtat 18 01 01: ne 3 (tre) permase qe fillon nga 3 L deri 12 L

- Kontenitor plastike te riperdorshem me qese plastmasi njeperdorimeshe, per mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, ne 3 (tre) permase qe fillojne nga 30 L deri ne 60 L, shoqeruar me mekanizem hapje me pedale per cdo permase, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.

- Kontenitor kartoni njeperdorimesh me permase rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04

- Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08

Per te provuar plotesimin e ketij kriteri operatori duhet te paraqese si pjese te dokumentacionit ne SPE, fature blerje ose zhdoganimi dhe Certifikimin e aprovimit te tipit te ambalazhit per seicilin lloj kontenitori.

Operatori duhet te sjelle per verifikim ne ambientet e Spitalit jo me vone se dita dhe ora e hapjes se ofertave, nga nje moster per seicilin lloj kontenitori.

-Ne lidhje me kerkesen per paraqitjen e "Kontenitor plastike te riperdorshem me qese plastmasi njeperdorimeshe, per mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, ne 3 (tre) permase qe fillojne nga 30 L deri ne 60 L, shoqeruar me mekanizem hapje me pedale per cdo permase, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3."

Nje kriter i tille eshte ne thelb diskriminues duke perjashtuar terthorazi nje Operator Ekonomik, ne rastin konkret, duke kerkuar ne menyre taksative qe OE te paraqese nje mekanizem hapje me pedale per cdo permase, pasi OE mund te disponoje/punoje (me) nje forme karele te ndryshme nga kjo e kerkuar ne DST. Duhet theksuar se karela ne vetvete ben transportimin e kontenitoreve. Per me teper mbajtesja metalike (karela) te ciles AK i referohet nuk ben mbyllje te sigurt te kapakut te kontenitoreve te mbetjeve (referuar te gjitha karelave te cilat bejne hapjen e kapakut me ane te pedanit), duke humbur keshtu ne teresi evitimin e kontaktit te personelit me mbetjet e infektuara. AK eshte e vetedijshme se kontenitoret jane te pajisura me qese, te cilat jane ne perputhje me te gjitha legjislacionin ne fuqi, dhe duke marre te mireqene faktin se punonjesit e spitalit respektojne me rigorozitet te gjitha masat parandaluese (maske, doreza, dezinfektant, etj), si e tille mundesia e kontaktit me pjese te infektuara eshte e paperfillshme.

Ky kriter shkel:

nenin 46.1 te LPP qe percakton "Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha kriteret e meposhtme, qe

autoriteti kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional; b) aftesia teknike; c) gjendja ekonomike e financiare; ç) kapacitetet ligjore nenin 23.1 te LPP "Specifikimet teknike, qe percaktoine karakteristikat e mallrave, puneve dhe sherbimeve qe do te prokurohen, duhet te pergatiten per te pershkruar sa me sakte dhe ne menyre te plote objektin e prokurimit, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Kur eshte e mundur, specifikimet teknike duhet te percaktohen ne menyre te tille qe te kuptohen nga personat me aftesi te kufizuara.

Nisur nga kjo kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:

8. Operatori duhet te furnizojë kontenoret sipas standarteve dhe kerkesave te VKM Nr. 798 date 29.09.2010 "Per administrimin e mbetjeve spitalore" pika 8/4 dhe 8/5 te kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

- Kontenitor plastike njeperdorimesh per te mprehtat 18 01 01: ne 3 (tre) permasa qe fillon nga 3 L deri 12 L

- Kontenitor plastike te riperdorshem me qese plastmasi njeperdorimeshe, per mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, ne 3 (tre) permasa qe fillojne nga 30 L deri ne 60 L, shoqeruar me mbajtese metalike /karele me rrota, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.

- Kontenitor kartoni njeperdorimesh me permase rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04

- Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08

Sa mesiper kerkojme qe ky kriter te hiqet nga Ak ose te plotesohet duke percaktuar qe denimi administrativ te jete i formes se prere.

II.5. Në datën 28.12.2020, nëpërmjet shkresës nr. 2311/1 Prot., datë 23.12.2020, me objekt "Dërgim informacioni", është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Medi Tel" sh.p.k. se "Nisur nga sa me siper kerkojme modifikim e ketij kriteri diskriminues, duke e ndare proceduren ne lote ne menyre qe te shmangen hapesirat per favorizimin e vetem nje OE te cakuar, i cili kerkon ta ktheje tregun ne momopol dhe eliminimin e OE te tjere te cilet edhe pse jane te licensuar nga organet kompetente me te gjithe dokumentacionin perkates, i eliminon ky kriter kaq diskriminues.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

**FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\*\*\*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

\*\*\*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH

| 1            | 2   | 3          | 4             | 5           | 6       |
|--------------|---|------------|---------------|-------------|---------|
| Nr           | Përshkrimi i Shërbimeve                               | Sasia (kg) | Çmimi / Njësi | Çmimi Total | Afati   |
|              | Grumbullim, trajtim dhe asgjësim i mbetjeve spitalore | 50000      |               |             | 24 muaj |
| Çmimi Neto ) |   |            |               |             |         |
| TVSH (%)     |   |            |               |             |         |
| Çmimi Total  |   |            |               |             |         |

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Shënim:

Çmimet duhet të shprehen në Monedhën \_\_\_\_ ( e kerkuar ne dokumentat e tenderit)

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet Teknike”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

Objekti prokurimit jane mbetjet e rrezikshme spitalore si vijon:

1. Bisturi, shiringa, instrumenta te mprehta te klasifikuara me kodin 18.01.01 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.01 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
2. Pjese te trupit dhe organe perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (te klasifikuara me kodin 18.01.02) sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.02 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
3. Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet (te klasifikuara me kodin 18.01.03) sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e pare ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
4. Mdikamente citostatike dhe citotoksike te klasifikuara me kodin 18.01.08 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e pare ne kodin 18.01.10 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010

5. *Medikamente te tjera pervec atyre citostatike dhe citotoksike te klasifikuara me kodin 18.01.09 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e fundit ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010.*
6. *Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi*
7. *Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Elbasan per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit.*
8. *Te sigurohet disinfektimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.*
9. *Operatori ekonomik duhet te furnizoje spitalin me te gjithë materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.*
10. *Mbetjet duhet te merren nga sipermarresi prane Spitali Elbasan me mjet te posacem te sipermarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme.*
11. *Trajtimi duhet te realizohet sipas legjislacionit ne fuqi dhe duhet te behen ta pa rrezikshme.*
12. *Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve.*

*Se fundmi tek Specifikimet teknike ne lidhje me mjetet, kontenitoret apo ambientin dhe impiantet, duhet te jene te pajisur me sinjalistiken dhe tabela sinjalizuese te cilat tregojne prezencen e mbetjeve te rrezikshme ne ambjentin/ambjentet perkatese te AK ne baze te VKM 798 date 20.09.2010 "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE", edhe ne Udhezuesit kombetar Administrimi i Sigurte i Mbetjeve Spitalore*

III.1.3. Në shtojcën 11 “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar se:

#### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

*Shërbimi që kërkohet:*

*Grumbullim, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore ne nje sasi prej 50000 kg*

*Afatet e ekzekutimit: 24 muaj nga lidhja e kontrates*

III.1.4. Referuar Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni, pika 2 prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë eficientësinë dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik
- d) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- e) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;”

III.1.5. Në kreun II, Neni 9, pika 5 e të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*“Kontrata ndahet në LOTE, kur përbëhet nga punë, mallra apo shërbime, homogjene ose të ngjashme, dhe kur vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i vogël operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Kjo mënyrë mund të përdoret veçanërisht për*

*të nxitur pjesëmarrjen e biznesit, të vogël e të mesëm, apo për të ulur kostot administrative të autoritetit kontraktor.”*

III.1.6. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “*Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore*”, në Kreun I, pika 1 dhe 2 Qëllimi dhe Objekti, parashikohet shprehimisht:

*“Kjo rregullore përcakton procedurat, rregullat dhe standardet teknike për administrimin e mbetjeve spitalore me qëllim mbrojtjen e shëndetit publik dhe të mjedisit”.*

a) *“Mbetje spitalore” janë mbetjet e krijuara nga prodhuesit e mbetjeve, ku përfshihen: mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat renditen në paragrafin 18 të vendimit nr.99, datë 18.2.2005 të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”.*

k) *“Mbetje e rrezikshme” përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioaktive, ujin dhe tretës të infektuar”.*

III.1.7. Në Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 “*Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore*”, në Kreun IV, “*Leja Mjedisore dhe Akt Miratimi Higjieno – Sanitar*”, parashikohet shprehimisht:

10.1. *Grumbullimi, transportimi, përpunimi dhe asgjësimi i mbetjeve spitalore kryhen nga organet kompetente shtetërore, personat juridikë publikë, si dhe personat fizikë apo juridikë privatë, që janë pajisur me lejen përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie.*

10.2. *Leja e veprimtarisë së mësipërme është e vlefshme në shkallë vendi dhe miratohet nga Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.*

10.3. *Inspektorati Sanitar Shtetëror, pas ekspertimit higjieno-shëndetësor, lëshon aktmiratim higjieno-sanitar për ushtrimin e veprimtarisë.*

III.1.8. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit vihet re se kjo procedurë ka për qëllim grumbullimin, trajtimin dhe asgjësimin e mbetjeve spitalore, mbetje të cilët janë si Bisturitë, shiringa, instrumente të mprehta me kod 18 01 01; Pjesë të trupit dhe organe, përfshirë qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut të klasifikuara me kodin 18 01 02; Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të veçante për të parandaluar infeksionet (të klasifikuara me kodin 18.01.03) sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e parë ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010; Medikamente citostatike dhe citotoksike të klasifikuara me kodin 18.01.08 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e parë në kodin 18.01.10 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010; Medikamente të tjera përveç atyre citostatike dhe citotoksike të klasifikuara me kodin 18.01.09 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e fundit ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010, të cilat referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “*Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore*” dhe konkretisht në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k), rezulton se bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të cilat duan metoda dhe trajtime të veçanta për asgjësimin e tyre po ti referohemi shtojcës 3 të kësaj VKM. Komisioni i Prokurimit Publik thekson se ndarja ose jo, e kontratës në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit (hartimit të kriterëve kualifikuese nga njësia e prokurimit) pasi ndikon drejtpërdrejt në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomike në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, etj., dhe veçanërisht faktin



nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të pakët, pra, gëzojnë në një farë mënyre të drejtën e prodhimit, apo distribucionit.

III.1.9. Komisioni nuk e gjykon të drejtë pretendimin e ankimuesit lidhur me ndarjen me lote të procedurës pasi referuar VKM nr. 798, datë 29.09.2010 “Për miratimin e rregullores për administrimin e mbetjeve spitalore” vëren se në Kreun I, pika 1 dhe 2 gërma (k) thuhet se: “Mbetje të rrezikshme përfshijnë mbeturinat e infektuara, patologjike, shpuese, farmaceutike, toksike, kimike dhe radioactive dhe tretës të infektuar”, nisur nga sa më sipër si dhe referuar specifikimeve teknike rezulton se mbetjet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor për asgjësim në këtë procedurë prokurimi bëjnë pjesë tek mbetjet e rrezikshme të parashikuara në VKM e sa mësipërcituar, dhe ndarja në Lote e procedurës së prokurimit sipas pretendimit të ankimuesit, do të komplikonte menaxhimin e kontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësive duke e komplikuar edhe realizimin me sukses të kontratës. Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor ka vepruar drejt dhe në përputhje me frymën e legjislacionit të sipërpërmendur.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Medi - Tel” sh.p.k. për modifikimin e kriterit “*Duke u bazuar ne legjislacionin ne fuqi, te LPP dhe te te drejtave qe i njeh Operatorit Ekonomik kerkojme modifikimin e ketij kriteri si me poshte:*

*Sherbime te ngjashme te realizuara gjate tre viteve te fundit, nga data e dorezimit te ofertave, ne nje vlere 20 % te fondit limit te vene ne dispozicion ose dispozicion ose 40 % e vleres se perllogasritur per 12 muaj (1 0'000'000. 00 lek pa TVSh). Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte.:*

- a. *Kur sherbimi i ngjashem eshte I realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar naa institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate. Ose*
- b. *kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat. ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 8, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 3.3. “*Kapaciteti teknik*” është përcaktuar kriteri si më poshtë:

*Sherbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e dorezimit te ofertave, në një vlerë 40 % te fondit limit te vene ne dispozicion. Keto sherbime te ngjashme do te vertetohen me dokumentacionin si me poshte:*

- a. *Kur sherbimi i ngjashem eshte i realizuar me institucione shteterore, Operatori ekonomik do ta vertetoje duke paraqitur Kontraten e nenshkruar me institucionin, te shoqeruar detyrimisht me vertetimin e leshuar nga Institucioni shteteror per realizimin e sukseshem te kesaj kontrate. ose*
- b. *kur sherbimi i ngjashem eshte realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vertetoje kete sherbim duke paraqitur faturat tatimore te shitjes ku shenohen sherbimi, shumat dhe vlerat.*

III.2.2. Në nenin 46, pika 1, gërma c, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. Gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur.”*

III.2.3. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 3, parashikohet si më poshtë:

*“Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

*Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

III.2.4. Referuar dispozitave ligjore të sipërcituara, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet ekonomike, besueshmërinë, dhe përvojën e duhur, në përputhje dhe në përpjestim me volumin e kontratës objekt prokurimi, për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur. Komisioni sjell në vëmendje të autoritetit kontraktor faktin se, duke qenë se fryma e Ligjit të Prokurimit Publik bazohet në këto parime: “mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; transparencë në procedurat e prokurimit; barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve”, kriteret për kualifikim duhet të hartohen në mënyre të tillë që të jenë gjithëpërfshirëse si dhe të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël e të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit të hartuara nga autoriteti kontraktor, konstaton se ky i fundit ka kërkuar shprehimisht në kriteret e vecanta të kualifikimit, që operatorët ekonomikë duhet të paraqesin *shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit, nga data e dorëzimit të ofertave, në një vlerë 40 % të fondit limit të vënë në dispozicion.* Nga verifikimi i dokumentave të tenderit dhe referuar bazës ligjore të sipërpërmendur, kriteri në lidhje me kontratat e ngjashme është përcaktuar në përputhje me kërkesat ligjore si dhe në kufijtë monetarë të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, të cilët duhet të jenë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së kontratës që do të prokurohet. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe

organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sa më lart, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin në lidhje me përvojën e ngjashme në përputhje me nenin 28, pika 3, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se “3. Pika 3.3.3 e kapacitetit teknik, ku thuhet: 3.Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem. Per te vertetuar permbushjen e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese: Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper;

- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjeter teknik i secilit impiant dhe makinerise;
- Deklarate Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerise,
- Akt Miratimin Higjeno-Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shenim: KVO do te verifikoje ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga secili mpiant.

a) Per sa i perket pikes ku OE pjesemares duhet te kete te perfshire ne Lejen Mjedisore makine per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve ju bejme me dije se kerkesa e mesiperme eshte diskriminuese dhe pengon OE te marrin pjese ne prokurime mbi bazen e nje kerkese te paplote.

I sjellim ne vemendje AK se Makinerite per larjen, spurcimin, dezinfektimin e kontenioreve, (makinat lereze) nuk perfshihen ne Lejet Mejdimore Tipi B apo A, por ato perfshiheshin ne Lejet Mejdimore Tipi C, te cilat jane hequr perfundimisht me Ligjin Nr. 52/2020.

Theksojme se OE MEDI-TEL shpk operon duke perdorur kontenitore plastike njeperdorimsh dhe si i tille pajisjen me impiant per larjen apo dezinfektimin e shikon totalisht te panevojshme, sepse kontenitoret qe kjo shoqeri perdor asgjesohen bashke me mbetjet dhe nuk ka asgje per tu lare apo dezinfektuar.

Ne keto kushte, AK nuk ka te drejte te vendose nje kerkese kaq diskriminues, por duhet ta heqe ate ose ta zevendesoje me:

Kandidati/ofertuesi duhet te dorezoje:

- Impiantet per trajtimin me sterilizim/asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e konteniereve duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose

te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper, ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.

Kriteri i mesiperme shkel:

- nenin 2 te LPP "Perzgjedhja e fituesve te kontratave publike realizohet ne perputhje me keto parime te pergjithshme:

a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabarte i ofertuesve ose kandidateve;

b) transparence ne procedurat e prokurimit;

c) barazi ne trajtimin e kerkesave dhe te detyrimeve, qe u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve"

-Lidhur me pretendimet e AK se ky kriter eshte vendosur per te mbrojtur mjedisin dhe se ka zbatuar piken 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit te mbetjeve, ju bejme me dije se pika 1.2 (faqe 5) - Parimet e administrimit te mbetjeve i referohet minimizimit te prodhimit te mbetjeve nga prodhuesit e tyre, ne kete rast minimizimin e mbetjeve qe gjenerohen nga Qendra Spitalore XHAFERR KONGOLI Elbasan dhe ska lidhje me menyren e asgjesimit apo me llojin e kontenitoreve qe perdoren.

-Perseri, ju bejme me dijene se OE MEDI-TEL shpk per te reduktuar ne pothuajse 0 (zero) emetime e gazrave te demshem ne atmosfere, prej muajit Mars 2020 ka investuar dhe eshte pajisur me nje incenerator te teknologjise se fundit "MEDIBURN 30", gje e cila ka ndikim te drejtperdrejte me mjedisin duke e permiresuar djegien deri ne ate nivel sa eshte e paperfillshme per mjedisin.

\*-Gjithashtu, se fundmi Lejet Mjedisore Tipi C jane hequr perfundimisht me Ligjin Nr. 52/2020 publikuar ne FLETOREN ZYRTARE te Republikes se Shqiperise date 28/05/2020 dhe Hyn ne fuqi 15 dite pas publikimit ne fletronen zyrtare, pra me date 12/06/2020.

Per nje kriter te tille ka dhe nje vendim te Komisionit te Prokurimit Publik (KPP) nr. 251/2020, i cili nuk pranon vendosjen e nje kriteri te tille.

Per sa me siper kerkojme modifikim e ketij kriteri si me poshte:

- 3. Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim / asgjesimin me incenerim te seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetieve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregulloria) si dhe makineri per larjen dhe dezinfektimin e konteniereve te riperdorshem ose ose nje vetedeklarim, ku deklaron se kontenitoret qe ai perdor jane njeperdorimsh.

Per te vertetuar permbushien e ketij kriteri operatori ekonomik duhet te paraqese:

Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);

- Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim duhet te jene te pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose te jene pasqyruar ne Lejet Mjedisore te te paraqitura ne permbushje te kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 me siper;

- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tieter teknik i secilit impiant dhe makinerise.

- Akt Miratimin Higjeno-Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriati Shendetesor Shteteror);

Shenim: KVO do te verifikoje ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga seicili impiant.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.3.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, Pika 3.3.3. në "Kapacitetin teknik", e Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit, është modifikuar si më poshtë:

3. Pika 3.3.3 në "Kapaciteti teknik" e Shtojcës 8

ISHTE

3. Vertetim se zoteron (pronesi ose me qera) impiant trajtimi konfort objektit të prokurimit. Per kete duhet te paraqese faturen e blerjes ose kontrate qeraje te parashikuar nga legjislacioni ne fuqi, per vertetimin e disponimit ne pronesi apo me qera (si psh fatura cdoganimi etj)

BËHET

3. Operatori duhet te kete ne pronesi ose me qera impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim të seciles kategori te prokuruar nga A.K te mbetjeve spitalore sipas Ligjit Nr. 10463 date 22.09.2011 "Per menaxhimin e integruar te mbetjeve", i ndryshuar, si dhe te VKM-se Nr. 798 date 29.09.2010 per miratimin e rregullores "Per administrimin e mbetjeve spitalore", (Rregullorja) si dhe makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm. Per të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Dokumentacionin per vertetimin e pronesise ose te marrjes me qera te pajisjes (ku afati i marrjes me qera te jete minimalisht me afatin e ekzekutimit te ketij objekti prokurimi);
- Impiantet per trajtimin me sterilizim /asgjesimin me incenerim dhe makineria larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve duhet të jenë të pajisur me Leje Mjedisore III.1.C dhe/ose III.1.B ose të jenë pasqyruar në Lejet Mjedisore te të paraqitura në përmbushje të kriterit 3.1.1 dhe 3.1.2 më sipër;
- Katalog ose skede teknike ose cdo dokument tjetër teknik i secilit impiant dhe makinerisë;
- Deklaratë Konformiteti CE i secilit impiant dhe makinerisë.
- Akt Miratimin Higjeno–Sanitar respektiv per impiantet e autoklavimit dhe incenerimit te leshuar nga ISHSH (Inspektoriat Shendetesor Shteteror);

Shënim: KVO do te verifikoje ne terren te dhenat per impiantet te paraqitura nga ofertuesit si me siper dhe realizimin e nje cikli pune nga seicili impiant.

III.3.2. Në shtojcën 9 "Specifikime teknike", të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Objekti prokurimit jane mbetjet e rrezikshme spitalore si vijon :

1. Bisturi, shiringa, instrumenta te mprehta te klasifikuara me kodin 18.01.01 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.01 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
2. Pjese te trupit dhe organe perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (te klasifikuara me kodin 18.01.02) sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.02 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
3. Mbetjet grumbullimi dhe asgjesimi i te cilave kerkon trajtim te vecante per te parandaluar infeksionet (te klasifikuara me kodin 18.01.03) sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e pare ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010
4. Mdikamente citostatike dhe citotoksike te klasifikuara me kodin 18.01.08 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e pare ne kodin 18.01.10 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010

5. *Medikamente te tjera pervec atyre citostatike dhe citotoksike te klasifikuara me kodin 18.01.09 sipas VKM nr.99 date 18.02.2005 ekuivalent me fjalia e fundit ne kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 date 29.09.2010.*
6. *Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi*
7. *Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Elbasan per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit.*
8. *Te sigurohet disinfektimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.*
9. *Operatori ekonomik duhet te furnizojë spitalin me te gjithë materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.*
10. *Mbetjet duhet te merren nga sipermarresi prane Spitali Elbasan me mjet te posacem te sipermarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme.*
11. *Trajtimi duhet te realizohet sipas legjislacionit ne fuqi dhe duhet te behen ta pa rrezikshme.*
12. *Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve.*

*Se fundmi tek Specifikimet teknike ne lidhje me mjetet, kontenitoret apo ambientin dhe impiantet, duhet te jene te pajisur me sinjalistiken dhe tabela sinjalizuese te cilat tregojne prezencen e mbetjeve te rrezikshme ne ambjentin/ambjentet perkatese te AK ne baze te VKM 798 date 20.09.2010 "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE", edhe ne Udhezuesit kombetar Administrimi i Sigurte i Mbetjeve Spitalore.*

III.3.3. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, Pika 9 e Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit, është modifikuar si më poshtë:

**ISHTE**

*9. Operatori ekonomik duhet te furnizojë spitalin me te gjithë materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.***BËHET**

*9. Operatori Ekonomik duhet të furnizojë me kontenierë AK sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 date 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:*

1. *Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: në 3 (tre) përmasa që fillon nga 3 L deri 12 L*
2. *Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhezuesit Kombetar te Administrimit te Sigurte te Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.*
3. *Kontenitor kartoni njëpërdorimësh me përmasë rreth 60 L per mbetje te buta 18 01 04*
4. *Kontenitor te posacem njeperdorimesh te kuq per mbetjet citostatike 18 01 08*

III.3.4. Në shtojcën 12 “Termet e Referencës”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*Objekt I kesaj kontrate jane te gjitha mbetjet infektive spitalore klasifikuar sipas kodit Evropian si jane mbetjet e buta (pelena, pambuke dhe garza mjekimi, tampon, fasho te ndryshme, sete infuzioni dhe sonda te ndryshme etj) ,te mprehta (age, shiringa, bisturi, aparate serumi etj) dhe anatomike (inde dhe organe ) dhe te gjitha mbetjet qe klasifikohen si te rrezikshme nga Autoriteti Kontraktor.*

*Detyrat:*

*Trajtimi duhet te realizohet sipas legjislacionit ne fuqi dhe duhet te behen ta pa rrezikshme.*

*Operatori ekonomik duhet te furnizojë spitalin me te gjithe materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.*

*Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Elbasan per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit.*

*Te sigurohet disinfektimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.*

*Shperndarja:*

*Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi*

*Vendi dhe dorezimi i shërbimeve:*

*Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve*

*Mbetjet duhet te merren nga sipermarresi prane Spitali Elbasan me mjet te posacem te sipermarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme.*

III.3.5. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

*“1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.3.6. Në nenin 28 pika 5 gërma “a” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*”5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose. [...]”*

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjisllacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.3.8. Në rastin konkret, nisur nga pretendimi i operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar për modifikimin e dokumentave të tenderit ka kërkuar shprehimisht që operatori duhet të ketë në pronësi ose me qera makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm. Gjithashtu në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar kontenitor plastikë të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, kështu që rrjedhimisht kërkesa për makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, është një kërkesë e domosdoshme dhe e cila i shërben qëllimit të kësaj procedure prokurimi duke ndikuar në cilësinë e kryerjes së shërbimit, pasi meqenëse kemi të bëjmë me mbetje spitalore, infektive, nevoja për larjen dhe dezinfektimit të këtyre kontenitorëve është e domosdoshme.

Për sa i përket pretendimit të operatorit ekonomik ankimues se, ky i fundit do të përdorë vetëm kontenitorë njëpërdorimësh, dhe kërkesa për makineri për larjen e tyre nuk është e domosdoshme, KPP vëren se, në specifikimet teknike të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar *“kontenitor plastikë të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.”*, kërkesë kjo e cila nuk është kundërshtuar nga operatorit ekonomik ankimues, rrjedhimisht, për sa kohë në kriteret e kualifikimit kërkohet përdorimi i kontenitorëve të ripërdorshëm për disa nga llojet e mbetjeve, rrjedhimisht kërkesa për makineri për larjen dhe dezinfektimin e kontenierëve të ripërdorshëm, është një kërkesë e domosdoshme dhe në përputhje me objektin e kontratës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Medi Tel” shpk për modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit me argumentin se *“Ne lidhje me kërkesen për paraqitjen e “Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.”*

*Nje kriter i tille eshte ne thelb diskriminues duke perjashtuar terthorazi nje Operator Ekonomik, ne rastin konkret, duke kerkuar ne menyre taksative qe OE te paraqese nje mekanizem hapje me pedale per cdo permase, pasi OE mund te disponoje/punoje (me) nje forme karele te ndryshme nga kjo e kerkuar ne DST. Duhet theksuar se karela ne vetvete ben transportimin e kontenitoreve. Per me teper mbajtesja metalike (karela) te ciles AK i referohet nuk ben mbyllje te sigurt te kapakut te kontenitoreve te mbetjeve (referuar te gjitha karelave te cilat bejne hapjen e kapakut me ane te*



pedanit), duke humbur kështu në teresi evitimin e kontaktit të personelit me mbetjet e infektuara. AK është e vetdijshme se kontenitorët janë të pajisura me qese, të cilat janë në përputhje me të gjithë legjislacionin në fuqi, dhe duke marrë të mirëqenë faktin se punonjësit e spitalit respektojnë me rigorozitet të gjitha masat parandaluese (maske, doreza, dezinfektant, etj), si e tillë mundësia e kontaktit me pjesë të infektuara është e paperfillshme.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën e publikuar nga autoriteti kontraktor për modifikimin e dokumentave të tenderit, Pika 9 e Shtojcës 9 të dokumentave të tenderit, është modifikuar si më poshtë:

**ISHTE**

9. Operatori ekonomik duhet të furnizojë spitalin me të gjithë materialet e nevojshme për ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti për mbetjet e buta dhe kontenitore për mbetjet e mprehta etj. Këto materiale duhet të jenë në ngjyrë të verdhë dhe të kenë të stampuar logon nderkombetare për mbetjet e rrezikshme infektive.

**BËHET**

9. Operatori Ekonomik duhet të furnizojë me kontenierë AK sipas standarteve dhe kërkesave të VKM Nr. 798 datë 29.09.2010 “Për administrimin e mbetjeve spitalore” pika 8/4 dhe 8/5 të kreut III, trajtimi i mbetjeve spitalore, si vijon:

5. Kontenitor plastike njëpërdorimësh për të mprehtat 18 01 01: në 3 (tre) përmasa që fillon nga 3 L deri 12 L
6. Kontenitor plastike të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për çdo përmasë, sipas Udhezuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3.
7. Kontenitor kartoni njëpërdorimësh me përmasë rreth 60 L për mbetje të buta 18 01 04
8. Kontenitor të posacem njëpërdorimesh të kuq për mbetjet citostatike 18 01 08

III.4.2. Në shtojcën 9 “Specifikime teknike”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Objekti i prokurimit janë mbetjet e rrezikshme spitalore si vijon :

1. Bisturi, shiringa, instrumenta të mprehta të klasifikuara me kodin 18.01.01 sipas VKM nr.99 datë 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.01 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010
2. Pjesë të trupit dhe organe perfshire qeset dhe konservuesit e gjakut dhe rezervat e gjakut (të klasifikuara me kodin 18.01.02) sipas VKM nr.99 datë 18.02.2005 ekuivalent me 18.01.02 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010
3. Mbetjet grumbullimi dhe asgjësimi i të cilave kërkon trajtim të vecantë për të parandaluar infeksionet (të klasifikuara me kodin 18.01.03) sipas VKM nr.99 datë 18.02.2005 ekuivalent me fjalë e parë në kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010
4. Mjekime citostatike dhe citotoksike të klasifikuara me kodin 18.01.08 sipas VKM nr.99 datë 18.02.2005 ekuivalent me fjalë e parë në kodin 18.01.10 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010
5. Mjekime të tjera përveç atyre citostatike dhe citotoksike të klasifikuara me kodin 18.01.09 sipas VKM nr.99 datë 18.02.2005 ekuivalent me fjalë e fundit në kodin 18.01.08 sipas VKM nr.798 datë 29.09.2010.

6. *Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi*
7. *Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Elbasan per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit.*
8. *Te sigurohet disifenktimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.*
9. *Operatori ekonomik duhet te furnizojë spitalin me te gjithë materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.*
10. *Mbetjet duhet te merren nga sipermarresi prane Spitali Elbasan me mjet te posacem te sipermarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme.*
11. *Trajtimi duhet te realizohet sipas legjislacionit ne fuqi dhe duhet te behen ta pa rrezikshme.*
12. *Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve.*

*Se fundmi tek Specifikimet teknike ne lidhje me mjetet, kontenitoret apo ambientin dhe impiantet, duhet te jene te pajisur me sinjalistiken dhe tabela sinjalizuese te cilat tregojne prezencen e mbetjeve te rrezikshme ne ambientin/ambjentet perkatese te AK ne baze te VKM 798 date 20.09.2010 "PËR ADMINISTRIMIN E MBETJEVE SPITALORE", edhe ne Udhezuesit kombetar Administrimi i Sigurte i Mbetjeve Spitalore.*

III.4.3. Në shtojcën 12 “*Termet e Referencës*”, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*Objekt I kesaj kontrate jane te gjitha mbetjet infektive spitalore klasifikuar sipas kodit Evropian si jane mbetjet e buta (pelena, pambuke dhe garza mjekimi, tampon, fasho te ndryshme, sete infuzioni dhe sonda te ndryshme etj) ,te mprehta (age, shiringa, bisturi, aparate serumi etj) dhe anatomike (inde dhe organe ) dhe te gjitha mbetjet qe klasifikohen si te rrezikshme nga Autoriteti Kontraktor.*

*Detyrat:*

*Trajtimi duhet te realizohet sipas legjislacionit ne fuqi dhe duhet te behen ta pa rrezikshme.*

*Operatori ekonomik duhet te furnizojë spitalin me te gjithë materialet e nevojshme per ambalazhimin e tyre si qese plastike me kuti per mbetjet e buta dhe kontenitore per mbetjet e mprehta etj. Keto materiale duhet te jene ne ngjyre te verdhe dhe te kene te stampuar logon nderkombetare per mbetjet e rrezikshme infektive.*

*Operatori ekonomik duhet te instaloje nje frigoriferi ne ambientet e Spitalit Elbasan per ruajtjen e mbejtjeve te rrezikshme spitalore anatomike te lengshme dhe te ngurta deri ne momentin e transportimit per ne impiantin e asgjesimit.*

*Te sigurohet disifenktimi i mire i frigoriferit dhe ambientit ku eshte instaluar.*

*Shperndarja:*

*Mbetjet e rrezikshme spitalore duhet të asgjësohen ne një impiant i cili është i licensuar nga Ministria e Mjedisit per kryerjen e këtij shërbimi*

*Vendi dhe dorezimi i shërbimeve:*

*Mbetjet do te peshohen ne pranine e perfaqesuesve te te dyja paleve*

Mbetjet duhet të merren nga sipërmarresi pranë Spitali Elbasan me mjet të posaçëm të sipërmarresit dhe me abalazhimin perkates ne perputhje me standartet e OBSH, per mbetjet e rrezikshme spitalore anatomike te ngurta dhe te lengshme.

III.4.4. Në Udhëzuesin Kombëtar Administrimi i Sigurt i Mbetjeve Spitalore, në pikën 7.2.3 parashikohet:

### 7.2.3 Specifikimet për tipe të ndryshme kontenierësh

Projektimi, materialet dhe ndërtimi i llojeve të ndryshme të kontenierëve për mbetjet spitalore duhet të ndjekë specifikimet e përcaktuara në Shtojcën E.



Foto 8. Koshat me pedal janë opsioni i preferuar për rrymën e mbetjeve spitalore potencialisht infektive.

III.4.5. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese.

III.4.6. Në nenin 23 pika 1, 2 dhe 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se : “1. Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara. 2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. 3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionale, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni

*për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj.”*

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përket rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

III.4.8. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e specifikimeve në lidhje me kontenitorin plastik të ripërdorshëm me qese plastmasi njëpërdorimëshe, për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, në 3 (tre) përmasa që fillojnë nga 30 L deri në 60 L, shoqëruar me mekanizëm hapje me pedale për cdo përmasë, sipas Udhëzuesit Kombëtar të Administrimit të Sigurte të Mbetjeve Spitalore, pika 7.2.3, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kërkesa e vendosur nga autoriteti kontraktor që ky kontenitor të jetë i shoqëruar me mekanizëm për hapjen me pedal, është në përputhje me Udhëzuesin Kombëtar për Administrimin e Sigurt të Mbetjeve Spitalore, pasi sipas këtij të fundit koshat me pedal janë opsion i preferuar për rrymën e mbetjeve spitalore potencialisht infektive. Në rastin konkret, nga autoriteti kontraktor këto kontenitor me mekanizëm pedal janë kërkuar për mbetjet anatomike 18 01 02 dhe ato infektive 18 01 03, me qëllim parandalimin e kontaktit me këto mbetje infektive.

Sa më sipër, kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor, është një kërkesë e domosdoshme, jo diskriminuese, e cila i shërben kryerjes me cilësi të shërbimit dhe në përputhje me parashikimet ligjore dhe udhëzuesit kombëtar të cilët rregullojnë fushën objekt prokurimi.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Medi Tel” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me nr. REF-80546-12-01-2020, me objekt “*Grumbullim, trajtim dhe asgjesim i mbetjeve spitalore – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara*”, me fond limit 20.000.000 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 05.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1725 Protokolli,**

**Datë 14.12.2020**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

|                      |                     |                      |                     |
|----------------------|---------------------|----------------------|---------------------|
| <b>Nënkryetar</b>    | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>        | <b>Anëtar</b>       |
| <b>Enkeleda Bega</b> | <b>Vilma Zhupaj</b> | <b>Lindita Skeja</b> | <b>Merita Zeqaj</b> |

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**